

Si Kryeministër, kishte imunitet



Agim Çeku nuk është i kërkuar ndërkombëtar nga Interpoli përmes "vërejtjes së kuqe". Ai është viktimë e "vërejtjes difuzive" të lëshuar nga Serbia në Interpol më 2002, e cila ishte ndaluar të jetë aktive sa ka qenë Kryeministër, meqë e drejta ndërkombëtare i ka dhënë imunitet. Këtë urdhër-arresti kombëtar serb ■ 14-5 nuk mund ta heqë Interpoli.



Prishtina dhe Shkupi duket se kanë tejkaluar problemet që u shfaqën muajin e kaluar, gjatë takimit joformal të presidentëve të rajonit, që u zhvillua në Vlorë. Presidenti Sejdiu fitoi homologun e tij maqedonas që ta vizitojë Kosovën. Ftesa u pranua nga Presidenti Ivanov. Kështu, u realizua një nga pritjet e nikoqirit të takimit, Presidentit shqiptar Bamir Topi. ■ 15

TENSIONET BEHEN KUJTIME

Spanja për Kadarenë

Shkrimtari shqiptar Ismail Kadare ka fituar çmimin më të madh letrar të Spanjës "Princi i Asturias", në një konkurrencë me shkrimtarë të njohur botërorë, si Haruki Murakami e Milan Kundera. Prej çmimeve të mëdha letrare, atij tani i ka mbetur vetëm edhe Çmimi Nobel. | FAQE 22

Për para, apo idealizëm?

Pieter Feith dhe Sadri Ferati mbrojnë me fanatizëm punën e bërë deri më tani në procesin e decentralizimit. Mbi 300 aplikacione të serbëve për ekipet përgatitore të komunave të reja janë shenjë për ta se ky komunitet po përfaqon ofertën e Prishtinës. Pakicat joserbe ankohen që Prishtina dhe ndërkombëtarët e kanë përqendruar vëmendjen vetëm te serbët. | FAQE 6

OpED Një déjã vu nga Tirana

Duke hedhur baltë dhe akuza që shkojnë deri në ekstrem, krijohet përshtypja se të gjithë janë njëloj, se kushdo që vjen në pushtet do vjedhë dhe do abuzojë, se në fund të fundit elektorati është i dënuar të zgjedhë atë që i paraqitet si e keqja më e vogël. Shkruan: Armand Shkullaku | FAQE 3

Express

E enjte

25 qershor, 2009

www.gazetaexpress.com

N° 1554, Viti III, Çmimi: 0.20 € • E përditshme e pavarur kosovare

RIKTHEHET NE GJYQ

Më 7 korrik

Gjykimi ndaj tre ish pjesëtarëve të UÇK'së, Rrustem Mustafa-Remi, Nazif Mehmeti dhe Latif Gashi, rifillon me 7 korrik. Në vitin 2003, ishin dënuar nga UNMIK'u, por vendimi që hedhur poshtë nga Gjykata Supreme. Ata akuzohen për krime lufte. ■ 18-9



FOTO: PETRIT RRAHMANI

Fillo!

Me pakon Fillo,
1 thirrje deri 30 minuta
kushton vetëm 10 centë.



HYN
n'ExpressOnline

www.gazetaexpress.com

duk^agjini
kompania e sigurimeve **gjini** insurance company

Letërsia shqiptare në "Kritikën e përkthimit"

Letërsia shqipe dhe përkthimi i saj në gjuhën angleze për herë të parë zënë vend në faqet e revistës "Translation Review" ("Kritika e përkthimit"). E cilësuar si revista më e madhe në botë për përkthimin nga gjuhët e tjera në anglisht, "Kritika e përkthimit" botohet prej

30 vjetësh nga Universiteti i Teksasit, në Dallas të SHBA-ve. Numri i 76-të i kësaj reviste, që publikohet dy herë në vit, i është kushtuar tërësisht letërsisë shqipe dhe përcjelljes së saj në botën anglishtfolëse, vështirësive të përkthimit etj. Në kopertinën e revistës në vijim të

kësaj ideje është vendosur një vepër e piktorit dhe scenografit shqiptar Andis Gjoni, e titulluar "Dedalus". Në brendësi "Kritika e përkthimit" hapet me një shkrim të albanologut, shkrimtarit dhe përkthyesit Robert Elsie. Në artikullin e tij Elsie, një prej përkthyesve kryesorë të letërsisë

shqipe në anglisht, bën një rishikim të shkurtër të letërsisë shqipe në botën anglishtfolëse nga viti 1595, kur dhe u përkthye vepra e parë në këtë gjuhë ("Historia e Skëndërbeut" e Marin Barletit) deri në ditët e sotme. Ai ndalet në përkthimin e "Këngëve të kreshnikëve", "Lahuta

e Malësisë", "Bagëti e Bujqësi", pjesë nga vepra e Migjenit, Koliqit etj. Për t'u ndalur edhe në periudhën e socrealizmit me përkthimet e veprave të shkrimtarëve Ismail Kadare, Fatos Kongolit etj. Pjesë nga vepra e shumë autorë të tjerë, si Elvira Dones, Kim Mehmeti, Ylljet Aliçka,



I ha drejt

Shkrimtari shqiptar Ismail Kadare ka fituar çmimin më të madh letrar të Spanjës "Princi i Asturias", në një konkurrencë me shkrimtarë të njohur botërorë si Haruki Murakami, apo Milan Kundera. Prej çmimeve të mëdha letrare, atij tani i ka mbetur vetëm edhe çmimi Nobel.

Alfred Beka

alfred.beka@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 24 QERSHOR —

Shkrimtari shqiptar Ismail Kadare është shpërblyer me çmimin letrar të Spanjës Prince of Asturias të mërkurën, duke u vlerësuar për angazhimin social në veprën e tij.

Lajmin e kanë bërë të ditur agjencitë spanjolle të lajme, por po ashtu edhe agjenci të tjera botërore. Duke e përshkruar atë si një prej autorëve më të mëdhenj të letërsisë botërore, organizatorët e çmimit kanë thënë se Kadare 'përfaqëson kulmin e letërsisë shqiptare dhe pa i harruar rrënjët e tij, ka kaluar kufij për t'u ngritur si zë universal kundër totalitarizmit.'

Lindita Arapi, Eqrem Basha, Fatos Lubonja, Teodor Laço, Dritëro Agolli etj., janë përfshirë në një antologji. Sipas Elsie, me gjithë përpjekjet e bëra nga shkrimtarë, përkthyes apo botues në hapësirën shqiptare e më tej, letërsia shqiptare ende nuk është shumë e njohur në botën anglishtfolëse. Si e tillë, ajo është një terren që ka shumë për t'u zbuluar. Në 82 faqet e revistës paraqiten një

sërë artikujsh rreth kësaj problematike, të përgatitur nga përkthyes të letërsisë shqipe, si Gjekë Marinaj, Frederick Turner, Piter. R. Prifti, Peter Morgan etj. Kjo problematikë e përkthimit është parë edhe nëpërmjet syve të vetë shkrimtarëve. Kështu, Ismail Kadare në intervistën dhënë për Gjekë Marinajn vlerëson rolin që luajnë përkthyesit në karrierën e çdo shkrimtari. Një rol i rëndësishë

së parë dhe unik për fatin e çdo shkrimtari dhe njohjen e tij në botë. Nga ana tjetër, Frederick Turner, i cili së bashku me Gjekë Marinajn kanë sjellë në anglisht disa prej poezive më të bukura të traditës e folklorit tonë, ndalet te metoda që ai ka përdorur për përkthimin e poezisë popullore shqiptare. Të tjerë përkthyes të letërsisë shqipe, si Ron Berisha, Peter Golub dhe Laura Bouers, kanë

bërë një rishikim të veprave të Rudolf Markut, Luljeta Lleshankut dhe Mujë Buçpapajt. Botimi i Universitetit të Teksasit në Dallas, "Kritika e përkthimit" është revista zyrtare e Shoqatës së Përkthyesve Letrare Amerikanë, organizatë prej 80 mijë anëtarësh, shumica akademikë që paguajnë 60-80 dollarë në vit për anëtarësim. Ajo shpërndahet falas tek ata dhe në shumicën e librarive

të universiteteve dhe qyteteve në Amerikë dhe Kanada. Botimi i këtij numri lidhur me përkthimin e letërsisë shqipe në botën anglishtfolëse, është bërë i mundur falë punës së Gjekë Marinajt, një prej poetëve më të lexuar të viteve të fundit, i cili njëkohësisht ka dhënë kontribut edhe në përkthimin në anglisht të veprave të disa autorëve shqiptarë dhe poezisë sonë popullore.

Shkrimtarët në rrugën për Nobelit

Çmimi Princi i Asturias

■ Këtë çmim më parë e kanë fituar shkrimtarë të ndryshëm si Jose Hierro, Juan Rulfo, Angel Gonzalez, Mario Vargas Llosa, Camilo Jose Cela, Claudio Rodriguez, Carlos Fuentes, Francisco Umbral, Gunter Grass, Augusto Monterroso, Doris Lessing, Arthur Miller, Susan Sontag, Claudio Magris, Paul Auster dhe Amos Oz. Shpërblimi për letërsi, me një

vlerë prej 50 mijë euro dhe me një riprodhim të statujës së dizajnuar nga Joan Miro, është i gjashti në mesin e çmimeve të tjera Prince of Asturias që ndahet këtë vit pas atij për arte (Norman Foster), Bashkëpunim Ndërkombëtar (Organizata Botërore e Shëndetësisë) Shkenca Shoqërore (David Attenborough), Shkenca Humane

dhe Komunikim (Universidad Nacional Autonoma de Mexico) dhe Hulumente Shkencore dhe Teknike, i cili u është dhënë inxhinierëve Raymond Tomlinson dhe Martin Cooper. Të themeluar në vitin 1981, çmimet prezantohen në Oviedo, kryeqendra e Principatës së Asturias, në një ceremoni të kryesuar nga Felipe, Princi i Asturias.

Çmimi i vitit 2009 i shpallur të mërkurën është një prej tetë çmimeve Asturias të ndarë çdo vit në fusha si artet, shkencat, bashkëpunimi dhe komunikimi ndërkombëtar etj.

Ky çmim iu akordohet personave, institucioneve, puna krijuese ose kërkimore e të cilëve përfaqëson një kontribut të madh në kulturën universale në fushat e letërsisë apo gjuhësisë.

Juria për ndarjen e çmimit ka qenë në përbërje të profesorit të letërsisë Andres Amoros, themeluesit të gazetës 'La Razon' dhe fituesit të çmimit Prince of Asturias Prize for Communications and Humanities në vitin 1991, Luis Maria Anson, shkrimtari Juan Jose Armas Marcelo dhe gazetarëve White Berasategui dhe Maria Luisa Blanco.

Veprat e Kadaresë së pari kanë zgjuar vëmendjen gjatë viteve të regjimit shtypës komunist të Enver Hoxhës. Romancier, eseist dhe poet, vepra e tij ka arritur famë ndërkombëtare pasi që i ishte pranuar azili politik në Francë në vitin 1990.

Ai është lindur në vitin 1936 në Gjirokastrë të Shqipërisë, qyteti jugor ku ishte lindur edhe Enver Hoxha. Në mesin e romaneve më

të popullarizuara të Kadaresë janë edhe "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Pallati i ëndrrave", "Koncert në fund të dimrit" etj.

Kandidat i rregullt për çmimin Nobel për letërsi, Kadare ka fituar çmimin e parë Man Booker Inter-

national në vitin 2005. Librat e tij janë përkthyer në më shumë se dyzetë gjuhë.

Çmimi Princi i Asturias ka vlerë prej 50 mijë euro si dhe një skulpturë të artistit Joan Miro. Çmimi është i emëruar sipas princit Fe-

lipë të Spanjës, titulli formal i të cilit është Princi i Asturias, rajon i Spanjës veriore.

Vitin e kaluar këtë çmim e kishite fituar shkrimtarja kanadeze Margaret Atwood, të cilën juria e nderoi për veprën e saj të shkëlqyer, sidomos në mbrojtjen e dinjitetit të grave.

Konkurrenca për këtë çmim ka qenë shumë e madhe, ku në mesin e 31 kandidatëve kanë qenë disa prej shkrimtarëve më të njohur botërorë, si p.sh. shkrimtari çek Milan Kundera, ai japonez Haruki Murakami, pastaj shkrimtari nga Uruguai Eduardo Galeano, romancier italian Antonio Tabucchi, shkrimtari britanik Ian McEwan, shkrimtarja kanadeze Alice Munro dhe ajo meksikane Elena Poniatowska. Po ashtu si kandidatë potencialë për të fituar këtë çmim kanë qenë edhe shkrimtarja hungareze Agota Kristof dhe ai holandez Cees Noteboom.

Ismail Kadare u lind më 28 janar 1936 në Gjirokastrë, ku përfundoi edhe arsimin e mesëm; më 1958 mbaroi degën e gjuhës e të letërsisë në Universitetin e Tiranës. Më pas shkoi në Moskë me studime për dy vjet në Institutin "Gorki". Ismail Kadare është shkrimtari me i madh i letërsisë shqipe dhe një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë bashkohore në botë. Me veprën e tij, e cila është përkthyer në më shumë se dyzetë gjuhë, ai e ka bërë të njohur Shqipërinë në botë, me historinë dhe me kulturën e saj shekullore.

Si fëmijë, Kadare ka qenë dëshmitar i Luftës së Dytë Botërore dhe okupimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, Gjermania naziste e më pas edhe nga Bashkimi Sovjetik, deri në krijimin e diktaturës së Hoxhës në vitin 1944.

Si njohës i mirë i traditave shqiptare, krijimtaria e tij zakonisht është e vendosur rreth ngjarjeve historike që kanë ndikuar në vendin e tij, siç është lufta kundër turqve 'Kështjella', Lufta e Dytë Botërore dhe pasojat e saj 'Gjenerali i ushtrisë së vdekur', prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik e më pas edhe me Kinën 'Koncert në fund të dimrit'.



Debati mbi identitetin shqiptar

■ Në vitin 2006, pas botimit të librit të Ismail Kadaresë "Identiteti evropian i shqiptarëve", nëpër mediat shqiptare filluan polemikat ndërmjet Kadaresë dhe Rexhep Qosjës, që u pagëzuan si debati Kadare-Qosja, ku trajtohej identi-

teti i shqiptarëve. Qosja e akuzoi Kadarenë se në librin e tij e kishte anashkaluar rolin e myslimanizmit në krijimin e identitetit shqiptar, duke e tkurrur kështu debatin dhe duke e shndërruar në debat mbi fenë e shqiptarëve. Kadare ia

kishte kthyer me një gjuhë shumë të ashpër, duke theksuar se Qosja e ka vendin në psikiatri. Në këtë debat më vonë u përfshinë edhe shumica e intelektualëve shqiptarë, disa duke ia mbajtur anën Kadaresë e disa Qosjës.

Shkrimtar disident?

■ Ekzistojnë mendime të ndryshme mbi faktin nëse Kadare ka qenë disident apo konformist gjatë periudhës komuniste. Shumica e medieve të huaja kur shkruajnë për Kadarenë e cilësojnë atë si disident. Mirëpo, në disa raste, Kadare e ka mohuar vetë se ka qenë disident. Në një intervistë në vitin 2006, pyetjes së gazetarit se a ka tentuar ta prezantojë veten si disident Kadare i ishte përgjigjur kështu: "Absolutisht jo. Të tjerët kanë thënë kështu dhe unë nuk mund të bëj asgjë kur gazetarët e huaj shkruajnë 'Shkrimtari disident Ismail Kadare...'".

Shumica besojnë se disa prej veprave të tij, siç është 'Pallati i ëndrrave' shfaqin paralele të fuqishme, duke e treguar egërsinë e regjimit komunist. Në ambientin politik dhe letrar të kontrolluar në tërësi dhe mizorisht nga shteti, vepra e Kadaresë ka qenë për shumicën e njerëzve e vetmja dritare që i afrohej realitetit. Megjithatë, në disa vepra ai e ka lavdëruar regjimin komunist dhe udhëheqësin Enver Hoxha. Ky fakt u jep argumente kritikëve të tij që e mohojnë disidencën e tij dhe e konsiderojnë si shërbëtor të regjimit. Në anën tjetër, mbrojtësit e tij thonë se ai i ka shkruar këto për t'i mbijetuar përndjekjes apo edhe pushkatimit. Ai i është referuar romanit të shumëkriktuar "Dimri i madh" si 'çmimi që ai e ka paguar për lirinë'.

Rrugën e krijimtarisë letrare e nisi si poet që në vitet e gimnazit, por u bë i njohur sidomos me vëllimin 'Shekulli im' (1961), që u pasua nga vëllimet e tjera poetike, si: 'Përse mendohen këto male' (1964), 'Motive me diell' (1968) dhe 'Koha' (1976). Vepra poetike e Ismail Kadaresë shquhet për idetë e thella dhe për figuracionin e pasur e original.

Në fushën e prozës, Ismail Kadare ka lëvruar tregimin, novelën dhe romanin. Prozën e tij e karakterizojnë përgjithësimet e gjëra historiko-filozofike, subjekti i ngjeshur dhe mendimi i thellë i shprehur shpesh me anë të parabolës, mbi bazën e asociacionit apo të analogjive historike. Ndër veprat e tij më të njohura në prozë përmendën: 'Gjenerali i ushtrisë së vdekur' (1964), 'Kështjella' (1975), 'Kronikë në gur' (1970), 'Ura me tri harqe' (1978), 'Pallati i ëndrrave' (1981) etj.